



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Virtual Era” Sh.P.K. të datës 24.05.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Virtual Era” Sh.P.K. të datës 24.05.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Virtual Era” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 24.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. – “Në tabelën e vlerësimit të ofertave, pjesa e çmimit është e ndarë në tre grupe me pesha të ndryshme: Grupi A (pozicionet 1-61) përbën 50% të peshës së çmimit total, Grupi B (pozicionet 62-70) përbën 30%, Grupi C (pozicionet 71-96) përbën 20%. Megjithatë, në përmbajtje të grupeve shihet se Grupi A, që merr 50% të peshës së vlerësimit të çmimit, përbëhet kryesisht nga produkte me rëndësi dhe vlerë të ulët në total, si p.sh. kabllo UTP në variante 0.5m deri 30m, të cilat përbëjnë vetëm 5-7% të vlerës së përgjithshme të ofertës. Në anën tjetër, produktet kryesore dhe me peshë më të madhe në ofertë, të renditura në Grupin C, i cili ka vetëm 20% të peshës së çmimit, nuk janë vlerësuar në mënyrë proporcionale me rëndësinë e tyre ekonomike dhe teknike. Kjo mënyrë e peshimit krijon një deformim të procesit të vlerësimit, duke favorizuar ofertat që mund të jenë më të lira në produktet me peshë të ulët, ndërkohë që produkteve kyçe u është dhënë një peshë relativisht më e vogël në vlerësimin përfundimtar”.

P.2. – “Ankesa për favorizim të prodhuesit Check Point dhe shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës 1. Argumentet teknike konkrete për bllokim të konkurrencës: Në dokumentacionin teknik të tenderit, kërkesat janë të dizajnuara në mënyrë që të favorizojnë ekskluzivisht prodhuesin Check Point, duke përjashtuar konkurrentët e tjerë në mënyrë të padrejtë. Këto janë specifikat teknike të cilat krijojnë bllokimin: Kërkesa për teknologjinë ClusterXL High Availability – kjo është një teknologji ekskluzive dhe patentë e prodhuesit Check Point, e cila nuk gjendet në pajisjet e prodhuesve të tjerë. Argumente shtesë që tregojnë se tenderi është i kufizuar vetëm për një prodhues (SMART Technologies): SMART BOARD dhe SMART Ink Termi "SMART BOARD" është një markë tregtare e SMART Technologies dhe lidhet me një teknologji të veçantë hardware software. SMART Ink është një teknologji ekskluzive e SMART Technologies që lejon shkrimin dhe shënimin mbi aplikacione të ndryshme (p.sh. Word, PDF, video, PowerPoint). Nuk është një funksion i përgjithshëm që e ofrojnë të gjithë prodhuesit e tjerë. Auto Draw Pen dhe Smart Object Awareness. Përmes këtyre teknologjive, termave dhe kërkesave teknike, tenderi është kryer në mënyrë që vetëm një prodhues – SMART Technologies – dhe operatori i autorizuar nga ata të mund të plotësojnë kriteret”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Rrjedhimisht sektori i prokurimit pranë AK ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë dhe shqyrtimin fillestar të pretendimeve ankimore. Me këtë rast njësia kërkuese ka ofruar sqarimet si vijon:

LIDHUR ME P.1. –

- Rënditja e Produkteve sipas Tableave: Grupi A, Grupi B dhe Grupi C, është bërë sipas prioritetit të punëve dhe të furnizimeve që do të kryehen sipas publikimit të njoftimit me nr. të prokurimit 616-25-69-62-1-1-1 dhe kërkesa për sasi është për 1 njësi, që do të thotë se kërkesa për kabull UTP mundet me qenë 1, 10, 100, 1000, 10 000 etj. Sikurse edhe për pajisje tjera, varet nga vendi “shkolla” ku do të implementohet projekti dhe cfare sasië nevojitet për

me përfunduar shkollën në fjalë, sikurse dhe për pajisje të tjera të Rrjetave Aktive, dhe për SMART Board.

- Gjithësesi forma e vlersimit të procedurës së tenderimit për të gjithë OE – është e njëjtë dhe si e tillë nuk përbën shkelje të transparencës apo diskreditim të OE. Dhe si e tillë forma aktuale qëndronë.
- AK – Konsideron se pretendimet Ankimore të OE – VIRTUAL ERA SH.P.K. janë të PA – BAZUARA.

LIDHUR ME P.2. –

- Kërkesa për teknologjinë ClusterXL High Availability – është teknologji e shpikur dhe e patnetuar nga check point, mirëpo si patentë ju është shitur dhe prodhuesve të tjerë sikurse janë: PaloAlto Networks, Fortinet FortiGate Firewall, Check Point Firewalls, Cisco Firepower, Sophos XG, Juniper SRX Series, Sonic WALL etj.
- Pra kemi min. 3 Prodhues që e ofrojnë teknologjinë e njëjtë CLUSTER HA.
- AK – Vleron se pretendimi ankimorë i OE – VIRTUAL ERA SH.P.K., se Teknologjia Cluster HA – Eleminon Prodhuesit të tjerë, nuk qëndron, pasi që janë min. 3 Prodhues që ofrojnë teknologjinë e njëjtë.
- SMART BOARD – Nuk është MARK TREGTARE !! është emertim internacional i një produkti, që do të thotë “TABEL E MENCURË”, dhe si emertim SMART BOARD, për identifikim të një produkti përdoret nga të gjithë prodhuesit.
- SMART INK – është një teknologji tani më e vjetruar, dhe si e tillë përdoret nga Dhjetra prodhues. Madje nuk do të mund të paramendohej përdorimi i SMART BOARD, pa pasur mundësinë me shënu mbi aplikacione elementare që përdoren gjatë mësimdhënies sikurse është WORD, PDF, Power Point etj. SMART INK, apo mundësia e shënimit mbi aplikacione e gjejmë te SMART BOARD e prodhuesve SAMSUNG, BENQ, ViewSonic, Microsoft e te dhjetra prodhues të tjerë internacional – brende të njohura.
- Auto Draw PEN dhe SMART Object Awareness – gjithashtu është një teknologji tani më e vjetruar, dhe si e tillë përdoret nga Dhjetra prodhues. Dhe si të tillë tani më dhjetra prodhues internacional – brende të njohura sikurse SAMSUNG, BENQ, ViewSonic, Promethean, Microsoft e kanë të integruara.
- AK – Vleron se pretendimi ankimorë i OE – Virtual ERA Sh.P.K., se specifikat teknike janë të përpiluar për të ju përshtaturë vetëm një prodhuesi është i pa – bazuar.
- Softueri për edukim SMART, monitorimi nga distanca dhe shpërndarja e materialve përmes CLOUD, disa nga prodhuesit që i posedojnë: BENQ, ViewSONIC, Promethean, Samsung, Smart Technologies, Microsoft, të gjitha këto Brenda sikurse edhe shumë të tjera kanë softuer për edukim të integruar, dhe që mundën me u menaxhu dhe me shpërnda materiale në CLOUD, duke përdorurë platëforma tashmë të njohura ndërkombëtare sikurse janë: GOOGLE, Microsoft, sikurse edhe CLOUD Server nga prodhuesit e SMART BOARDS.
- Software në gjuhen Shqipe, koha për implementimin e projektit, liferimin, instalimin, konfigurimin dhe trajnimin është paraparë mbrenda 3 – muajve. Prandaj edhe softwer për ligjerim duhet të jetë në gjuhen Shqipe – mbrenda 3 muajve – në finalizim të plotë të projektit. Nuk mundemi me ju imponu Mesimdhensve me dite me patjeter gjuhe te huaja per perdorime te aplikacioneve the softuerit per ligjerime. Gjithësesi shumica e prodhuesve ndërkombëtare tani vetëm se e kanë Gjuhen Shqipe të integruar në softwarët e tyre.
- AK – Vleron se pretendimi ankimorë i OE – Virtual ERA Sh.P.K., se specifikat teknike janë të përpiluar për të ju përshtaturë vetëm një prodhuesi është i pa – bazuar.
- OPS – PC Integration: Pothujase të gjithë prodhuesit serioz të SMART Boards, e kanë mundësinë e integritit të OPS – PC Integration, në mënyrë që klienti me zgjedh në mes të opsionit për përdorim Android apo Windows përmes OPS – PC Integration. Nuk është funksion ekskluziv për asnjë prodhues, pothujse të gjithë e ofrojnë mundësinë e integritit të PC në SMART BOARD. Gjithësesi është kërkuar që të ketë mundësinë e integritit, jo të jetë i integruar.

- Shitja, instalimi, konfigurimi, trajnimi për përdorimë është e domosdoshme me qenë të autorizuar nga prodhuesi, në mënyrë që AK me u siguru se pajisjet nuk po i blenë nga një OE – që nuk ka njohuri të mjaftueshme se si duhet të trajtohen pajisjet në fjalë.
- TOUCH POINT – Të gjithë prodhuesit e lartëpërmendur, sikurse janë BENQ, VIEWSONIC, Promethean, supports UP TO 40 Multi TOUCH POINTS.
- Gjithashtu, Wi-fi gen. 6, WPA3 dhe Bluetooth 5.0 – të gjithë prodhuesit e lartëcekur e përkrahinë, nuk është ndonjë teknologji e re dhe ekskluzivitet e asnjërit nga prodhuesit e pretenduar në kërkesën për Rishqyrtimë.
- AK – Vleron se pretendimi ankimore i OE – Virtual ERA Sh.P.K., se specifikat teknike janë të përpiluar për të ju përshtaturë vetëm një prodhuesi është i pa – bazuar.
- PËRFUNDIM: Pas shqyrtimitë me kujdes të “Kërkesës për Rishqyrtimë”, të OE – VIRTUAL ERA SH.P.K., AK – Vleron se të gjitha pretendimet Ankimore janë të PA – BAZUARA, rrjedhimisht nuk favorizojnë një Prodhues të caktuar dhe nuk janë në kundërshtimë me LPP, dhe si të tilla mbeten specifikat aktuale. Gjithësesi të gjithë OE – kanë mundësi të ofertojnë specifika më të avancuara se sa specifikat e kërkuara ne FTD”.

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në sqarimet e njësisë kërkuese është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e papabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.